



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 05/L -017

**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 03/L-246 PËR
PAJISJE ME ARMË, MUNICION DHE PAJISJE PËRKATËSE TË
SIGURISË PËR INSTITUCIONET E AUTORIZUARA SHTETËRORE
PËR SIGURI**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 03/L-246
PËR PAJISJE ME ARMË, MUNICION DHE PAJISJE PËRKATËSE TË
SIGURISË PËR INSTITUCIONET E AUTORIZUARA SHTETËRORE
PËR SIGURI**

Neni 1

1. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 1. nënparagrafi 1.1. riformulohet me tekstin si në vijim:

1.1. **Institucionet e autorizuara shtetërore të sigurisë** - përfshijnë: Forca e Sigurisë së Kosovës, Policinë e Kosovës, Inspektoratin Policor të Kosovës, Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë, Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, Shërbimin Korrektues, Doganën e Kosovës, Agjencinë Pyjor të Kosovës, Agjencinë e Kosovës për Forenzikë si dhe institucionet tjera të autorizuara të cilat mund të krijohen me ligj të veçantë.

2. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 1. fshihen nënparagrafët 1.3., 1.4., 1.5., 1.6., 1.7., 1.8., 1.9., 1.10., 1.11., 1.12., 1.13., 1.14., 1.15., 1.16., 1.17., 1.18., 1.20., 1.21., 1.22., 1.23., 1.24., 1.25., 1.26., 1.27., 1.28., 1.29., 1.30., 1.31., 1.32. dhe 1.33.

3. Neni 3 i ligjit bazik, pas paragrafit 1. shtohet paragrafi i ri 1.a me tekstin si në vijim:

1.a. Shprehjet tjera të përdorura në këtë ligj dhe në ligjin bazik kanë kuptimin e njëjtë ashtu siç janë përkufizuar në Ligjin për Armë.

Neni 2

Neni 4 i ligjit bazik, paragrafi 5. fjala „njëzet (20) vjet“ zëvendësohet me fjalën „tridhjetë (30) vjet.

Neni 3

Neni 5 i ligjit bazik riformulohet me tekstin si në vijim:

1. Kategoritë e mëposhtme të armëve mund të përdoren nga Policia e Kosovës, sipas Ligjit për Armët:

- 1.1. Kategoria A1, e kufizuar në 37 mm ose platforma të ngjashme për lansim;
- 1.2. Kategoria A2, armë zjarri automatike;
- 1.3. Kategoria A4, por e kufizuar në municion me predha gome për menaxhim të turmave;
- 1.4. Kategoria A6, armë e zjarrit me zhurmëmbytës të montuar;
- 1.5. Kategoria A7, armë zjarri me tytë të vjaskuar me kalibër mbi 12,7 milimetra;
- 1.6. Kategoria A8, mjetet plasëse dhe pjesët e tyre;
- 1.7. Kategoria A9, armë për përdorim të agjenteve kimik dhe municioni i saj;
- 1.8. Kategoria A10, pajisja e veçantë për armë zjarri e cila mundëson ndryshimin a armës së zjarrit në kategori tjetër nga origjinalja;
- 1.9. Kategoria A11, armë me elektroshok (paralizues elektrikë);
- 1.10. Kategoria A12, municioni gjurmëlënës;
- 1.11. Kategoria A16, armët e zjarrit me tyta poligonale;
- 1.12. Kategoria B1, armët e shkurta të zjarrit gjysmë-automatike apo përsëritëse;
- 1.13. Kategoria B2, armë zjarri të shkurtra për një qitje, me ndezje qëndrore;
- 1.14. Kategoria B3, armë me ndezje anësore të shkurtra për një qitje, me gjatësi të përgjithshme më të vogël se 28 cm;

1.15. Kategoria B4, armë zjarri të gjata gjysmë-automatike, me arkëz dhe fole për fishekë që së bashku mund të mbajnë më tepër se tre fishekë;

1.16. Kategoria B5, armë zjarri të gjata gjysmë-automatike, me arkëz dhe fole për fishekë së bashku, që mund të pranojnë deri në tre fishekë dhe mbushësi i të cilave ndërrohet, përkatësisht kjo armë mund të konvertohet, me ndihmën e veglës së rëndomtë, me ç' rast arkëzat e fishekëve mund të pranojnë më tepër se tre fishekë;

1.17. Kategoria B6, armë zjarri e gjatë gjysmë-automatike ose me përsëritje me tytë të pavjaskuar të gjatë deri në 60 cm;

1.18. Kategoritë C1, armë zjarri e gjatë me përsëritje, që nuk është përfshirë në kategorinë B6;

1.19. Kategoria C2, armë zjarri e gjatë me një gjuajtje me tytë të vjaskuar;

1.20. Kategoria C3, armë zjarri e gjatë gjysmë-automatike, që nuk është përfshirë në kategorinë B4, B5, B6;

1.21. Kategoria C4, armë e shkurtër zjarri me një qitje, me goditje anësore, gjatësia e përgjithshme e së cilës nuk është më e vogël se 28 cm;

1.22. Kategoria C5, armë zjarri me një qitje, e gjatë me tytë të pavjaskuar;

1.23. Kategoria C7, armë për sinjalizim me dritë dhe akustikë;

1.24. Kategoria C8, armë dhe municion për pasivizim të përkohëshëm të kafshëve

1.25. Kategoria C9, adaptues;

1.26. Kategoria D4, armët e ftohta.

2. Kategoritë e mëposhtme të armëve mund të përdoren nga Agjencia e Kosovës për Inteligjencë:

2.1. Kategoria A2, armë zjarri automatike;

2.2. Kategoria A11, armë me elektroshok (paralizues elektrikë)

2.3. Kategoria A16, armët e zjarrit me tyta poligonale dhe të kufizuara në pistoleta;

2.4. Kategoria B1, armët e shkurta të zjarrit gjysmë-automatike apo përsëritëse dhe të kufizuara në pistoleta;

2.5. Kategoria B6, armë zjarri e gjatë gjysmë-automatike ose me përsëritje me tytë të pavjaskuar të gjatë deri në 60 cm;

2.6. Kategoritë C1, armë zjarri e gjatë me përsëritje, që nuk është përfshirë në pikën 6 të kategorisë B;

3. Kategoritë e mëposhtme të armëve mund të përdoren nga Shërbimi Korrektues:

- 3.1. Kategoria A1, të kufizuara 37 mm ose platforma të ngjashme për lansim;
- 3.2. Kategoria A2, armë zjarri automatike.
- 3.3. Kategoria A10, pajisja e veçantë për armë zjarri e cila mundëson ndryshimin e armës së zjarrit në kategori tjetër nga origjinalja;
- 3.4. Kategoria A11, armë me elektroshok (paralizues elektrikë);
- 3.5. Kategoria A16, armë zjarri me tyta poligonale dhe të kufizuara në pistoleta;
- 3.6. Kategoria B1, armët e shkurta të zjarrit gjysmë-automatike apo përsëritëse dhe të kufizuara në pistoleta;
- 3.7. Kategoria B6, armë zjarri e gjatë gjysmë-automatike ose me përsëritje me tytë të pavjaskuar të gjatë deri në 60 cm;
- 3.8. Kategoria C1, armë zjarri e gjatë gjysmë-automatike ose me përsëritje me tytë të pavjaskuar të gjatë mbi 60 cm;

4. Kategoritë e mëposhtme të armëve mund të përdoren nga Dogana e Kosovës:

- 4.1. Kategoria A16, armët e zjarrit me tyta poligonale dhe të kufizuara në pistoleta.
- 4.2. Kategoria B1, armët e shkurta të zjarrit gjysmë-automatike apo përsëritëse dhe të kufizuara në pistoleta;

5. Kategoritë e mëposhtme të armëve mund të përdoren nga Agjencioni Pyjor i Kosovës:

- 5.1. Kategoria B6, armët e zjarrit të gjata përsëritëse dhe gjysmë-automatike me tyta të pavjaskuara që nuk janë më të gjata se 60 cm; dhe
- 5.2. Kategoria C1, armë zjarri e gjatë me përsëritje që nuk është përfshirë në kategorinë B6.

6. Kategoritë e mëposhtme të armëve mund të përdoren nga Inspektorati Policor i Kosovës:

- 6.1. Kategoria A16, armët e zjarrit me tyta poligonale dhe të kufizuara në pistoleta.
- 6.2. Kategoria B1, armët e shkurta të zjarrit gjysmë-automatike apo përsëritëse dhe të kufizuara në pistoleta;

7. Kategoritë e armëve të përcaktuara nga paragrafi 1 deri në paragrafin 6 të këtij neni mund të përdoren nga Akademia e Kosovës për Siguri Publike për qëllime trajnimi dhe arsimimi përpjesëtarët e institucioneve shtetërore të autorizuara për siguri.

8. Agjencia e Kosovës për Forenzikë mund:

8.1. të posedoj armë për qëllim koleksionimi referues cilat janë tëkonfiskuara me vendim të plotfuqishëm të gjykatës apo të blihen përmes procedurave të rregullta të prokurimit sipas ligjeve në fuqi;

8.2. të posedoj municion për qëllim të testimit balistik të armëve. Municioni për armë të zjarrit mund të merret nga municioni i konfiskuar me vendim të plotfuqishëm të gjykatës apo të blihet përmes procedurave të rregullta të prokurimit sipas ligjeve në fuqi.

Neni 4

Neni 18 i ligjit bazik, paragrafi 3 riformulohet me tekstin si në vijim:

3. Kërkesa për këtë lloj të lejes shqyrtohet dhe vendoset nga komisioni shqyrtues sipas Ligjit për armë dhe kërkesa do të përfshijë verifikimin e së kaluarës financiare dhe ligjore si dhe kontrollin e sigurisë së personit përgjegjës. Vendimi i komisionit shqyrtues është i formës përfundimtare. Pala e pakënaqur kundër këtij vendimi mund t'i drejtohet gjykatës themelore kompetente.

Neni 5 Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 05/L -017
23 korrik 2015**

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Kadri VESELI